

7323/1
12.11.18



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI QARKU ELBASAN

SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 970/ prot.

Elbasan, më 7.11.2018

Lënda: Konfirmim i aktit.

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.136 dt.25.10.2018 "Për shtesa dhe ndryshime në VKB nr.129 datë 20.11.2017 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Elbasan, për vitin 2018, i ndryshuar", dhe konfirmoj në parim bazueshmërinë në ligje.

PREFEKTI

Maksim MALAJ





1970
2.11.2018



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 7323 Prot.

Elbasan më 02.10.2018

VENDIM

Nr. 136 Datë 25.10.2018

“Për shtesa dhe ndryshime në VKB nr.129 datë 20.11.2017 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Elbasan, për vitin 2018”, i ndryshuar”.

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ____10.2018, pasi shqyrtoi propozimin e Kryetarit të Bashkisë, për specifikimin e taksës së kantierit dhe uljen e nivelit të vendosjes së garancisë financiare për heqjen e inerteve mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në ligjin nr.44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, në ligjin 107/2014 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, dhe në VKM nr. 575 datë 24.06.2015 “Për Miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.

VENDOSI:

1. Në vendimin e Këshillit Bashkiak nr.129, datë 20.11.2017 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Elbasan, për vitin 2018” bëhen keto ndryshime:

Tabela C/2- Vendosja e garancisë financiare për heqjen e inerteve, ndryshohet.

2. Tabela C/2 ndryshon si më poshtë:

Tabela – C/2 – Vendosja e garancisë financiare për heqjen e inerteve

Garancia financiare	% e vlerës së investimit
Garancia financiare për heqjen e inerteve së ndërtimit	3% e vlerës së investimit sipas taksës së lejes

Në mbështetje të pikës 10 të VKM nr.575 datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”. Subjekti fizik/juridik, kërkues i lejes për ndërtimin, riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit, përpara marrjes së lejes së ndërtimit duhet të depozitojë një garanci financiare për llogari të NJQV-së, e cila nuk do të jetë më e vogël se 3% e vlerës së strukturës së objektit. Në pikën 11 të VKM nr.575 datë 24.06.2015 citohet: Në rast të mospërmbyesjes së kushteve të sipërpërmendura, NJQV-ja konfiskon garancinë financiare.

3. Tabela G – Tarifa për zënien e hapësirës publike , ndryshohet dhe shtohet .

Tabela G ndryshon si më poshtë:

*	Tarifë kantieri/ prishje objekti ose Rikonstrukcion	15.000 lekë/vit
*	Tarifë kantieri për objekt deri në 250 m ²	25.000 lekë/vit
*	Tarifë kantieri për objekt 250 – 400 m ²	40.000 lekë/vit
*	Tarifë kantieri për objekt shumëkatësh me qëllim fitimi nga firmat e ndërtimit	100.000 lekë/vit
*	Tarifë zënie trualli publik për kantier – investitorë të tjerë për qëllime jo fitimi	30.000 lekë/vit
*	Tarifë zënie trualli publik për kantier - me qëllim fitimi nga firmat e ndërtimit	50.000 lekë/vit

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Projekteve , Drejtoria e Shërbimit të Territorit Urban dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd Gripshi



KRYETARI
Altin Idrizi

NË MUNGESË
ZV/KRYETARI
Zheni Gjergji



Konceptoi

Drejtori i DPTP

Drejtori i DPSHO

Drejtori i IMT

Drejtori i DSHTU

Drejtori i DTVMA:

Drejtori i DPPAABF:

Drejtorja Juridike:

Zv/kryetari:

S. Harja

G. Tabaku

E. Kënuti

L. Kaja

A. Hajrullai

A. Saraçi

Q. Tusha

O. Deliallisi

K. Xhoxhi